

MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Zbatimit të Ligjit të Republikës së Hungarisë për bashkëpunim

Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë dhe Zbatimit të Ligjit të Republikës së Hungarisë, këtu e tutje të referuara si "Ministritë",

Duke dëshiruar të krijojnë një bashkëpunim efektiv në mes të Ministrive,

Duke qenë të vetëdijshëm se bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar është i rëndësishëm së veçantë për të dy Ministrinë,

Duke pasur parasysh interesin e tyre të përbashkët në fushën e luftimit të migracionit ilegal,

Duke pasur parasysh obligimet e tyre ndërkombëtare dhe legjislacionin e brendshëm,

janë dakorduar si në vijim:

Neni 1

Ministritë do të mbështesin bashkëpunimin në kuadër të fushave të tyre të kompetencës në fushat në vijim:

- a) luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit ndërkombëtar;
- b) luftën kundër prodhimit, kultivimit, importimit dhe eksportit, transportimit dhe trafikimit ilegal të drogave, substancave psikotropike dhe pararendësve të tyre;
- c) veprimet të përbashkët kundër migracionit ilegal dhe krimeve përcjellëse;
- d) bashkëpunimin në fushat tjera të aktiviteteve për zbatim të ligjit.

Neni 2

Ministritë do të bashkëpunojnë në bazë të kërkesës në format në vijim:

- a) shkëmbim të informatave mbi baza ligjore;
- b) shkëmbim të ekspertëve;
- c) grupeve të përbashkëta punuese, konsultimeve në mes të ekspertëve;
- d) organizimin e konferencave, punëtorive dhe aktiviteteve tjera mbi çështjet që përfaqësojnë interesat e të dy Ministrive;
- e) shkëmbimin e përvojave mbi strukturën dhe përgjegjësitë e policisë;
- f) këmbimin e përvojave të fituara në aplikimin shkathtësive dhe pajisjeve teknike që përdoren në punën e policisë.

Neni 3

Ministritë do të promovojnë krijimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit direkt në mes të qendrave trajnuese Kosovare dhe Hungareze për zbatim të ligjit .

Neni 4

Ministritë do të përdorin gjuhën angleze në implementimin e këtij Memorandumi.

Ministritë do të paguajnë vet për të gjitha shpenzimet që ndërlidhen me implementimin e dispozitave të këtij Memorandumi, përveç nëse ndryshe është përcaktuar.

Përmbajtja e informatave të marra në kuadër të kornizës së këtij Memorandumi mund t'u zbulohen (tregohen) palëve të treta vetëm me pëlqim të Ministrisë që transmeton informacionin e tillë. Ministritë nuk mund të zbulojnë informatat individuale dhe konfidenciale në kuadër të kornizës së këtij Memorandumi.

Neni 5

Ky Memorandum nuk krijon obligime ligjore ndërkombëtare të reja dhe nuk ndikon në obligimet tashmë ekzistuese ndaj vendeve tjera apo ligjit/eve të brendshme.

Neni 6


Të gjitha kontestet që kanë të bëjnë me interpretimin dhe implementimin e këtij Memorandumi do të zgjidhen përmes konsultimeve në mes të Ministrive.


Neni 7

Ky Memorandum mund të ndryshohet në qdo kohë duke u bazuar në pëlqimin me shkrim të Ministrive.

Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe mbetet i vlefshëm derisa njëra Ministri e shpall të pavlefshëm përmes një njoftimi me shkrim së paku gjashtë muaj përpara.

Nënshkruar në Budapest më 26 Qershor 2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, hungareze dhe angleze, duke qenë të gjitha tekste autentike në mënyrë të barabartë. Në rast të ndonjë shmangie në përkthim dhe zbatim të këtij Memorandumi, teksti në gjuhën angleze do të mbizotëron.


Në emër të
Ministrisë së Punëve të Brendshme të
Republikës së Kosovës


Në emër të
Ministrisë së Drejtësisë dhe Zbatimit të
Ligjit
të Republikës së Hungarisë